

Nr. 1548/ Prot

Durrës, më: 18.06.2025

V E N D I M

Nr. 46, datë 18.06.2025

PËR

"RIORGANIZIM NËN MASËN 20% TË PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMIT, MASTER PROFESIONAL NË "PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE ZHVILLIMORE", PRANË FAKULTETIT TË EDUKIMIT, TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës"

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar; VKM-në nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"; VKM-në nr.185, datë 25.3.2021, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar; Udhëzimin MASR Nr.1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", i ndryshuar; Udhëzimin e MAS Nr.2, datë 21.01.2025, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë"; në Statutin e UAMD; Rregulloren e UAMD; si dhe në relacionin e Drejtorisë së Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave me Nr. 1338/1 prot., datë 04.06.2025, në mbledhjen e datës 18.06.2025, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Miratimin e riorganizimit nën masën 20% të programit të ciklit të dytë të studimit, Master Profesional në "Psikologji Shkollore dhe Zhvillimore", pranë Departamentit të Psikologjisë, në Fakultetin e Edukimit, të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:

- Zv. Rektorët,
- Drejtuesi i Njësisë Kryesore,
- Drejtuesi i Njësisë Bazë,
- Drejtoria e Kurrikulave dhe Standarteve të Cilësisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi për vitin akademik 2025-2026.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim FORTI

